

# Raport i Transparences VITI 2022

## Aida Maloku-Person Fizik

Informacion per vitin ushtrimor 01.01.2021-31.12.2021

09 Maj 2023

## **Hyrje**

Ky raport publikohet ne raport me kerkesat e ligjit nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar neni 45.

Studio afron sherbime per mbajtje kontabiliteti, konsulenca fiskale, sherbime auditimi si edhe misione bashkimi, ndarje shoqerish, ndryshime te kapitalit te regjistruar.

Per vitin 2022 studio ka realizuar te ardhura ne shumen 25.997 mije leke. Te ardhurat nga sherbimet e auditimit, jane 16.616 mije leke. Sherbime te tjera si kontabiliteti, sherbime vleresimi e te tjera sherbime, jane ne shumen 9.381 mije leke.

## **Struktura ligjore**

Kabineti auditimit me auditues ligjor Aida Maloku ushtron aktivitet si person fizik, regjistruar me nipt K32612411T, e themeluar ne perputhje me kerkesat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, i ndryshuar, me adrese Lagja Kastrioti, Rruga Brigada e 11 Sulmuese, Pallati nr.58, kati i dyte, Fier. Prej dates 29.10.2012 eshte hapur nipt sekondar ne adresen: Rruga Nasi Pavllo, pallati firmes Dola, perballe Drrerjtorise se Shendetit, Tirane.

Kabineti perbehet nga 5 punonjes ne satfin e tij, nga te cilet 4 ekonomiste dhe nje jurist.

## **Politikat e kontrollit te cilesise**

Politikat e kontrollit te cilësisë janë rregulla per te dhene siguri qe studio te jete ne perputhje me standartet profesionale, kerkesat rregullatore, ligjore dhe qe sherbimi i ofruar te jete i nje cilesie te larte. Qëllimi i këtyre politikave është përmirësimi i cilësisë së shërbimit të studios duke identifikuar dhe korrigjuar çdo mangësi apo problem që mund të ndodhë gjatë ofrimit të shërbimeve, vlerësimin dhe monitorimin e proceseve, marrjen e masave korrektuese dhe sigurimin e një përgjigje efektive ndaj çdo situatë që ndikon negativisht në cilësinë. Politikat e cilësisë përcaktojnë detyrat dhe përgjegjësitë për çdo punonjes të studios ato gjithashtu sigurojnë trajnimin dhe aftësimin e personelit për të kuptuar dhe zbatuar standartet dhe procedurat e cilesise.

## **Sherbimet e ofruara**

Sherbimet e ofruara jane: sherbime auditimi, mbajtje kontabiliteti, konsulenca fiskale si edhe misione bashkimi, ndarje shoqerish, ndryshime te kapitalit te regjistruar. Sherbimet tona kryhen ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit, Standartet Nderkombetare te auditimit. Ne jemi te perkushtuar ndaj cilesise se sherbimeve qe ofrojme. Disa aspekte të cilësisë së këtyre shërbimeve përfshijnë: -Saktësia dhe Përputhshmëria Ligjore: Sigurimi që të gjitha shërbimet të jenë të bazuar në standarde profesionale dhe të përputhen me ligjin dhe rregulloret financiare dhe tatimore që janë në fuqi. Kjo përfshin interpretimin e saktë të legjislacionit tatimor, të udhëzimeve në zbatim të tyre, si dhe çdo ndryshimi të mundshëm në ligj që mund të ndikojë te klientët tane. -Pavarësia dhe Objektiviteti: Sigurimi që auditimi, konsulenca dhe raportimi financiar tatim-taksa të jenë të kryer në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke minimizuar konfliktet e interesit dhe ndikimin e palëve të treta. Kjo përfshin implementimin e proceseve dhe politikave për të garantuar pavarësinë dhe objektivitetin e procesit të vendimmarrjes dhe të raportimit. -Profesionalizmi dhe Kompetenca: Sigurimi që personeli i përfshirë në ofrimin e këtyre shërbimeve të ketë njohuri të thella dhe aftësi të duhura

në fushën e auditimit, konsulencës dhe raportimit financiar tatim-taksa. Kjo përfshin trajnimin dhe aftësimin e vazhdueshëm të personelit për të qenë në vijim me zhvillimet aktuale në fushën e tyre të ekspertizës. Kommunikimi Efektiv: Sigurimi që klientët të informohen dhe këshillohen në mënyrë efektive dhe të qartë në lidhje me çështjet financiare dhe tatimore që ndikojnë në biznesin e tyre. Kjo përfshin komunikimin e rregullt dhe transparent me klientët, duke ofruar analiza dhe rekomandime të hollësishme për të mbështetur vendimmarrjen e tyre. Integriteti dhe Etika: Sigurimi që të gjitha shërbimet të ofrohen në përputhje me standardet etike më të larta dhe duke respektuar integritetin dhe konfidencialitetin e informacionit të klientëve. Kjo përfshin respektimin e kërkesave të kodit të etikës profesionale dhe të zbatimit të proceseve për të mbrojtur të dhënat dhe informacionin e klientëve.

### **Informacione financiare**

Ndarja e te ardhurave te shoqerise per vitin 2021 eshte si ne vijim:

Sherbimi kryer	per vitin e mbyllur ne 31.12.2021 te ardhurat ne mije leke
Auditime	16,616
Kontabilitet	972
Te tjera	8,409
totali	25,997

### **Njesite ekonomike me interes public**

Perkufizimi i njesise ekonomike me interes public eshte ai i dhene me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 17, datë 16.01.2019 “Për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre”. Shoqëritë klasifikohen me interes publik ne varesi- te natyres se biznesit, -madhësisë se tyre dhe -numrit te punonjesve.

Gjate vitit 2022 Shoqeria kreu auditimin e pasqyrave financiare te vitit 2021 per entitetet me interes publik si vijon:

Emri i klientit të audituar	Fusha e aktivitetit të klientit
Klodi sha	Shoqëri Tregtimi
Myrto Security	Shoqëri Shërbimi
Krasniqi sa	Shoqëri Tregtimi
Ujesjelles Kanalizime sha Mallakaster	Shoqëri Shërbimi
Sark shpk	Shoqëri Ndertimi
NG Structures shpk	Shoqëri Ndertimi
Ujesjelles Kanalizime sha Roskovec	Shoqëri Shërbimi
Albgaz sha	Shoqëri Shërbimi
Ujesjelles Kanalizime sha Lezhe	Shoqëri Shërbimi
MuhoPlus ltd.	Shoqëri Tregtimi
Albpetrol sha	Shoqëri Prodhimi
Balkan Monark trade shpk	Shoqëri Tregtimi
Albcontrol sha	Shoqëri Shërbimi
Resuli Er sha	Shoqëri Tregtimi
Klubi Shumesportesh Apollonia	Shoqëri Shërbimi

Auditues Ligjor

Aida Maloku


